



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA SHTIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Nr.09/81

Datë: 20. 6. 2023

**THIRRJE PUBLIKE**  
**Për Mbështetje Financiare Publike të Organizatave Jo-Qeveritare në Zbatimin e Aktiviteteve Kulturore dhe Rinore në Komunën e Shtimes**

Në bazë të nenit 12 të Rregullorës MF Nr.04.2017 mbi kriteret, standardet, dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) e Komunës së Shtimes shpall thirrje për të gjitha organizatat jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe individët, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës dhe rinisë, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e aktiviteteve, zhvillimin, masovizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në Komunën e Shtimes.
  2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:  
**2.1.Të gjitha OJQ-të, Kulturore dhe Rinore dhe individët në Komunën e Shtimes, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës dhe rinisë,**
  3. Organizatat jo-qeveritare dhe individët mund të aplikojnë me një projekt që kontribuon në avancimin dhe fuqizimin e sektorit të kulturës dhe rinisë.
  4. Vlera totale e planifikuar, e thirrjes është: **30,000.00 euro**
  5. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë nga data **20. 6. 2023** deri më datë **4. 7. 2023**.
  - 6.OJQ-të mund të aplikojnë me projekte në kuadër të kësaj thirrjeje, por vetëm me një projekt për fushën sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të thirrjes është deri në **dhjetor të vitit 2023**. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes publike.
- 6.1 Kriteret për aplikim**
- Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës .
  - OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e kulturës dhe rinisë.
  - OJQ-të duhet po ashtu të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofertuesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofertuesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

- Para nënshkrimit të kontratës OJQ duhet të paraqes prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (Obligative)
- Certifikatën e numrit fiskal (Obligative)
- Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore, i cili duhet të dorëzohet komisionit vlerësues para publikimit të rezultateve përfundimtare (pas publikimit të rezultateve preliminare të përfituesve) (Obligative).
- Të ketë dorëzuar projekt propozimin të plotësuar në formatin e aplikacionit sipas kërkesave të thirrjes publike (Obligative)

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilët së bashku me udhëzimet për aplikantë janë në dispozicion në uebfaqën e internetit të Komunes së Shtimes. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën: Rruga "Tahir Sinani" Nr.50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës /Zyra e Sportelit.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlersimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në zyrat e DKRS.



Drejtoresha, Albana Fazliu